

Datë: 01 Korrik, 2019

## PERGJIGJET NE KOMENTET E OPERATOREVE

### NGA

### KËSHILLIMI PUBLIK I DOKUMENTIT

## “RIPËRTRIRJA E AUTORIZIMEVE INDIVIDUALE PËR TË DREJTËN E SHFRYTËZIMIT TË KAPACITETEVE FREKUENCORE NË BREZET 900 DHE 1800 MHz PËR OPERATORËT TELEKOMI I KOSOVËS SH.A. DHE IPKO TELECOMMUNICATIONS LLC”

Dokumenti ‘Ripërtrirja e autorizimeve individuale për të drejtën e shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore në brezet 900 dhe 1800 MHz për operatorët Telekom i Kosovës sh.a. dhe IPKO Telecommunications LLC’ është përgatitur mbështetur në nenin 1, neni 3, paragrafi 1), nenit 10, nenet 46 deri 51, nenit 54 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 4), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe neni 82 paragrafi 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (tutje referuar si – Ligji ose LKE); nenit 9 të Rregullores nr.22 për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave (Ref. Nr.Prot.054/B/13) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP).

Sipas Vendimit Nr. 1388 (Ref. ARKEP Nr. Prot. 056/B/19)<sup>1</sup> të datës 07 Qershor 2019, ARKEP ka miratuar fillimin e procedurës së Konsultimit Publik të dokumentit të referuar më lartë nga data; **07 Qershor 2019** deri më datë; **21 Qershor 2019**.

Gjatë periudhës së Konsultimit Publik, komente kanë dërguar operatorët si në vijim:

- 1) **Telekomi i Kosovës sh.a.** – Komentet e dërguara më datë 21 Qershor 2019 (Ref. ARKEP Nr. Prot.396/2/19),

<sup>1</sup> <http://arkep-rks.org/?cid=1,26,1158>

- 2) **IPKO Telecommunications LLC** - Komentet e dërguara më datë 21 Qershor 2019 (Ref. ARKEP Nr. Prot.394/2/19),
- 3) **Dardafon.Net LLC** - Komentet e dërguara më datë 21 Qershor 2019 (Ref. ARKEP Nr. Prot.392/2/19).

Bordi i Autoritetit pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga operatorët, në mbledhjen e 41-të me radhë të mbajtur më datë 28 Qershor 2019 ka miratuar përgjigjet/qëndrimet e ARKEP ndaj komenteve të dërguara, të cilat janë paraqitur në tabelat si në vijim (Shtojcat I, II, dhe III).

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
1	Pika 7, c) faqe 18	Telekomi i Kosovës planifikon që periudha e vlefshmërisë së shfrytëzimit të rinovimit të këtyre resurseve frekuencore të aplikoj për 15 vite, por, para se të deklarohemi përfundimisht, nevojitet vendimi final i ARKEP për kushtet e pagesës në kuptim të kësteve vjetore.	<p>ARKEP konfirmon qëndrimin se operatorët kanë të drejtë të aplikojnë për periudha brenda intervalit: 10 deri 20 vite. Vlerësimi i brezeve frekuencore është bërë për periudhën 15 vjeqare, ndërsa për periudha të ndryshme përlogaritja e cmimit do të bëhet sipas formulës:</p> $Vlera e Brezitet_N = \left( \sum_{t=0}^{N-1} \frac{1}{(1+WACC)^t} / \sum_{t=0}^{15-1} \frac{1}{(1+WACC)^t} \right) \times Vlera e Brezitet_{15}$ <p>Sa i përket pagesës në këste, ARKEP në këtë proces lejon mundësinë e pagesës me këste vjetore të çmimit "one-off" sipas normës se interesit të Obligacioneve të Thesarit të Republikës së Kosovës, duke aplikuar normën e interesit në baza vjetore.</p> <p>Operatorët përveç mundësisë së pagesës së përnjëhershme "one off", kanë mundësi të përzgjedhin një nga opsionet e ndarjes në këste si më poshtë, për të cilin do të paguajnë normë interesi respektiv të dhënë në këtë tabelë në kolonën mesatarja e baraspeshuar.</p>

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP												
			<table border="1" data-bbox="989 240 1934 544"> <thead> <tr> <th data-bbox="989 240 1566 354">Instrumenti (Obligacioni)/ ndarja në kiste</th> <th data-bbox="1566 240 1934 354">Norma e interest e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="989 354 1566 391">Ndarja në kiste 2 Vjeçare</td> <td data-bbox="1566 354 1934 391">1.24507</td> </tr> <tr> <td data-bbox="989 391 1566 428">Ndarja në kiste 3 vjeçare</td> <td data-bbox="1566 391 1934 428">1.27999</td> </tr> <tr> <td data-bbox="989 428 1566 466">Ndarja në kiste 5 vjeçare</td> <td data-bbox="1566 428 1934 466">2.44155</td> </tr> <tr> <td data-bbox="989 466 1566 503">Ndarja në kiste 7 vjeçare</td> <td data-bbox="1566 466 1934 503">3.51486</td> </tr> <tr> <td data-bbox="989 503 1566 544">Ndarja në kiste 10 vjeçare</td> <td data-bbox="1566 503 1934 544">5.28238</td> </tr> </tbody> </table> <p data-bbox="961 594 1850 626">Ndërsa përlllogaritja e pagesës vjetore llogaritet sipas formulës në vijim.</p> <p data-bbox="961 680 1959 786">Nëse autorizimi është për D vite dhe pagesa “one-off” do të bëhet sipas viteve për kohezgjatjen e autorizimit (D vite), atëherë pagesa vjetore për vitin e parë llogaritet:</p> $P1 = \frac{Vlera\ e\ Brezit_D}{D}$ <p data-bbox="961 932 1881 964">Ndërsa pagesa ne ketet tjera (D-1 këste të barabarta) llogaritet si ne vijim:</p> $Pagesa\ Vjetore = (Vlera\ e\ Brezit_D - P1) \times \frac{i}{1 - (1 + i)^{1-D}}$ <p data-bbox="961 1114 1959 1187">Ku i- është norma e interesit/kuponit të Obligacioneve te Thesarit të Republikës së Kosovës e shprehur per D-1 vite</p> <p data-bbox="961 1276 1959 1398">Në rast të përcaktimit për pagesën me këste vjetore, me qëllim të sigurimit të realizimit të pagesës, ARKEP do të aplikoj mekanizmat adekuat të specifikuar në autorizime, duke përfshirë pasojat për operatorët për mos pagesë eventuale.</p>	Instrumenti (Obligacioni)/ ndarja në kiste	Norma e interest e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar (%)	Ndarja në kiste 2 Vjeçare	1.24507	Ndarja në kiste 3 vjeçare	1.27999	Ndarja në kiste 5 vjeçare	2.44155	Ndarja në kiste 7 vjeçare	3.51486	Ndarja në kiste 10 vjeçare	5.28238
Instrumenti (Obligacioni)/ ndarja në kiste	Norma e interest e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar (%)														
Ndarja në kiste 2 Vjeçare	1.24507														
Ndarja në kiste 3 vjeçare	1.27999														
Ndarja në kiste 5 vjeçare	2.44155														
Ndarja në kiste 7 vjeçare	3.51486														
Ndarja në kiste 10 vjeçare	5.28238														

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
			<p>Pagesa “one-off” ose kësti i parë, duhet të realizohet brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e lëshimit të fatures.</p> <p>Në rast se operatori nuk e përmbush obligimin për pagesë, atëherë ARKEP do të veproj si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për cdo vonesë në pagesa do të aplikohet masa ndëshkimore prej 8% për shumën e faturuar;</li> <li>- Në qoftë se për dy vite me radhë operatorët nuk kryejn pagesat e përcaktuara me Vendim, ARKEP nëpërmjet procedurës së përmbartimit do të ekzekutoj tërë shumën e mbetur duke përfshirë normën e aplikuar.</li> </ul>
2	Pika 7, e) faqe 18	TK-ja ka në përdorim 10 MHz e para të brezit P-GSM dhe nuk preferon të bëhet ndonjë zhvendosje e këtij brezi, njëjtë vlenë edhe për 1800 Mhz, ku TK ka në shfrytëzim 25 MHz të alokuara duke filluar nga fundi. Preferohet të mbahen të njëjtat radhitje të frekuencave.	ARKEP konfirmon se nuk do të ketë zhvendosje të blloqeve frekuencore, por përkufizimi i skajit të epërm të bllokut në brezet 900 dhe 1800 MHz do të bëhet në përputhje me Planin e Shfrytëzimit dhe shpërndarjes.
3	Pika 7, h) faqe 18	<p>Rikujtojmë ARKEP që Telekomit i Kosovës është duke kaluar në një fazë shumë të vështirë financiare. Andaj, TK kërkon që nga praktika nga e kaluara të aplikoj mënyrën lineare si në shembullin më poshtë:</p> <p>Llogaritja e spektrit të frekuencave</p>	Shih përgjigjen në pikën 1.

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		<p>për periudha 15 vjeçare në mënyren lineare ka marë për bazë normën e interesit prej 2.13% e cila është marr konform përcaktimit të ARKEP, që norma të merret nga TM aktual që publikon Ministria e Financave “TË DHËNAT TRE-MUJORE MBI BORXHIN E PËRGJITHSHEM” dhe të aplikoj mesataren e peshuar të normave të interesit të realizuar në ankandin e emetimit për të gjitha Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës (shih: <a href="https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/1093D492-A5FC-4878-A6C6-823E4FA40494.pdf">https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/1093D492-A5FC-4878-A6C6-823E4FA40494.pdf</a> fq.12).</p>	
4	Pika 7, h) faqe 18	<p>TK kërkon që nëse gjatë viteve në vijim përmiresohet gjendja e likuiditetit të kompanisë, të lejohet nga ARKEP që pagesa e vlerës së mbetur të bëhet në konceptin “One off fee”, në mënyrë që të mos aplikohet më tutje norma e interesit e cila në momentin e kalkulimit arrinë në 2.13%.</p>	<p>ARKEP konsideron se operatorët duhet të përcaktohen për njerin nga opsionet e pagesës (one off ose keste vjetore).</p> <p>Operatorët kanë të drejtë që pas një periudhe të caktuar kohore pagesa e vlerës së mbetur të bëhet në konceptin “One off fee”, dhe me këtë rast nuk do të aplikohet më tutje norma e interesit. Njoftimi nga ana e operatorit për mundësinë e pagesës për pjesën e mbetur duhet të bëhet së paku 3 muaj me herët.</p>

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
5	/	<p>Telekomi i Kosovës përshëndet iniciativën e ARKEP për rivlerësimin e brezeve frekuencore me të cilën dukshëm ka lehtësuar vazhdimin e operimit të ndërmarrjes. Por, gjithashtu duhet të merret parasysh se edhe përkundër kësaj, duke marr për bazë sfidat nëpër të cilat po kalon tregu i telefonisë mobile, kodi shtetëror, marrëveshjet aktuale të roamingut, TK vlerëson që çmimet për pagesat vjetore për përdorimin e frekuencave dhe përqindja e nivelit të pagesës së mbikëqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike ende mbeten shumë të larta dhe duhet rishikuar.</p>	<p>Sic jeni në dijeni ARKEP ka bërë një zbritje të konsiderueshme (30% deri 50%) të tarifave për mbikëqyrje të spektrit dhe të drejtën e përdorimit, si dhe një zbritje prej 40% të tarifave vjetore për numeracion.</p> <p>ARKEP është në proces të amandamentimit të Rregullores për Pagesat për Mbikqyrjen e tregut të Komunikimeve Elektronike ku do të shqyrtohen edhe komentet dhe sygjerimet e operatorëve.</p>

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e IPKO Telecommunications LLC	Përgjigja e ARKEP
		<p><b>Çmimet dhe metodologjia</b> - Ne i mirëpresim zbritjen e çmimeve të përcaktuara në dokument, sepse siç e kemi theksuar shumë herë deri më tani, rënia ishte thelbësore për një aktivitet normal të operatorëve mobil në Kosovë. Në metodologjinë e përdorur nga ARKEP, na mungon akoma hapi i fundit, që është rregullimi për tregun kosovar, përkatësisht konvertimi i PPP për Kosovë. Kjo me siguri do të ulte çmimin më shumë, për të cilën ne konsiderojmë se ende ka hapësirë për zbritje të mëtutjeshme, pasi që tregu i telefonisë celulare në Kosovë po kalon kohët më sfiduese, veçanërisht duke marrë parasysh zbatimin e kodit shtetëror dhe marrëveshjet e roaming-ut me Shqipërinë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, do t'i shkaktoj IPKO's humbje në baza vjetore në shumën prej 1.5 milion EUR/vit. Të trija këto</p>	<p>ARKEP ka analizuar dhe marrë në shqyrtim dy kurset e këmbimit – kursi i këmbimit SPOT (Hapi 4A) ose kursi i këmbimit PPP (Hapi 4B).</p> <p>Normat e PPP në parim duhet të përdoren si të ardhura të operatorëve dhe kostot për inputet e blerë në vend (p.sh., vendet e punës) varen nga fuqia blerëse e monedhës vendase. Megjithatë, në të shumtën e rasteve, infrastruktura dhe pajisjet mobile kanë tendencë të importohen dhe kostoja do të varet nga kursi i këmbimit në vend. Për më tepër, shumë operatorë të rrjetit mobil aktualisht operojnë në shumë vende dhe tregjet e monedhës mund të ndikojnë në ngritjen e kapitalit për të financuar ofertat e spektrit.</p> <p>Kështu, rentabiliteti i operatorëve dhe gatishmëria e tyre për të paguar për spektrin do të reflektoheshin përmes të dyja qasjeve: përmes PPP-së dhe spot-rregulluar. Për qartësi dhe transparencë, në këtë studim janë raportuar dy grupe vlerash (konvertuar duke përdorur PPP dhe spot), dhe rezultatet janë konsideruar së bashku me rezultatet ekonometrike në vlerësimin e vlerave për grupet që vlerësohen.</p> <p>Sidoqoftë, në përputhje Kornizën Rregullatore, praktikat e vendeve tjera, si dhe rekomandimin e kompanisë konsulente, mbetet në diskrecionin e Rregullatorit (ARKEP) si institucion përgjegjës për përcaktimin e çmimit, që të përcaktohet se cilën qasje do t'a përdorë.</p> <p>ARKEP ka përcaktuar çmimet duke u bazuar edhe në arritjen e objektivave rregullatore të specifikuar në Planin për Hapjen e Brezeve. Prandaj, ARKEP ka ardhur në përfundim se vlera e pageses “one-off” për periudhën 15 vjeçare për resurset frekuencore që do të jenë objekt i ripërtirjes së autorizimeve individuale për operatorët Telekomit të Kosovës dhe IPKO Telecommunications</p>



Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e IPKO Telecommunications LLC	Përgjigja e ARKEP
		<p>obligime rregullative do të dobësojnë pozitën e IPKO's në këtë treg, prandaj çfarëdo lehtësimi i mëtutjeshëm i çmimeve do të zbuste barrën dhe dëmin që operatorët po pësojnë nga implementimi i këtyre obligimeve rregullatore.</p> <p>Në veçanti, çmimet vjetore për mbikëqyrjen e tregut, çmimet vjetore për përdorimin e frekuencave dhe numeracionin mbeten shumë të larta, megjithatë, për këtë pjesë IPKO do të vijë me një kërkesë të veçantë.</p>	<p>LLC do te jete:</p> <p><b>Brezi: 900 MHz cmimi "one-off" eshte 0.141 €/MHz/Pop.</b></p> <p><b>Brezi: 1800 MHz cmimi "one-off" eshte 0.0705 €/MHz/Pop.</b></p> <p>Numri i popullësisë në Kosovë do të merret nga të dhënat e fundit zyrtare nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK), respektivisht raportin e publikuar te dates 28 Qershor 2019:</p> <p><b>Numri i popullësisë 1,795,666 banorë</b>  <a href="http://ask.rks-gov.net/media/4892/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2018.pdf">http://ask.rks-gov.net/media/4892/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2018.pdf</a></p> <p>Sic jeni në dijeni ARKEP ka bërë një zbritje të konsiderueshme (30% deri 50%) të tarifave për mbikëqyrje të spektrit dhe të drejtën e përdorimit, si dhe një zbritje prej 40% të tarifave vjetore për numeracion.</p> <p>ARKEP është në proces të amandamentimit të Rregullores për Pagesat për Mbikëqyrjen e tregut të Komunikimeve Elektronike ku do të shqyrtohen edhe komentet dhe sygjerimet e operatorëve.</p>
		<p><b>Harmonizimi i afatit të vlefshmërisë së autorizimeve për të drejtën e shfrytëzimit të frekuencave me Telekomin e Kosovës</b> - lidhur me harmonizimin e periudhës së validitetit të frekuencave me TK, ju lusim që tek formulimi i bërë në</p>	<p>ARKEP konsideron se në procesin e ripërtrirjes së autorizimeve është më e përshtatshme që të përfshihen të gjitha kapacitetet frekuencore, vlefshmëria e të cilave skadon më datat 30 Korrik 2019 dhe 6 Mars 2022.</p> <p>Sidoqoftë, me kërkesë të operatorit IPKO ripërtrirja e autorizimit për kapacitetet frekuencore që skadojnë më datë 6 Mars 2022 mund të bëhet në një periudhë të mëvonshme, por jo më vonë se 6 muaj para skadimit të autorizimit. Megjithatë,</p>

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e IPKO Telecommunications LLC	Përgjigja e ARKEP
		<p>pikën b) të seksionit 7 të dokumentit, të qartësohet nëse kushtet për alokimin e frekuencave, (sic është çmimi apo ndonjë kusht tjetër) do të mund të ndryshonin në vitin 2022, kur edhe skadojnë shumica e frekuencave të IPKO's. Një gjë e tillë do të na mundësoj që të bëhen planifikime të sigurta për të ardhmen. Përveç kësaj, nëse IPKO vendos të ndjekë inkurajimin e ARKEP për të harmonizuar vlefshmërinë e autorizimit me Telekomin e Kosovës, kërkojmë që dokumenti në fjalë të bëjë një dallim të qartë në mes të ripërtëritjes së frekuencave që skadojnë tani në korrik 2019, me vazhdimin e autorizimit individuale për të drejtën e shfrytëzimit të frekuencave që skadojnë në vitin 2022. Respektivisht, autorizimet që skadojnë në vitin 2022 të trajtohen si vazhdim i autorizimit, në mënyrë që IPKO të ketë mundësi që ta trajtoj në mënyrë të përshtatshme këtë në librat e vet</p>	<p>kushtet për alokimin e frekuencave duke përfshirë çmimin "one-off", lejmi i pagesës në këste, mënyra e ndarjes, mund të ndryshojnë.</p> <p>Sa i përket kërkeses për alokimin e kapacitetit shtesë prej 2x5MHz në brezin 1800 MHz, ARKEP konsideron se ky është proces i ndarë nga ripërtëritja e autorizimeve dhe caktimi i kapaciteteve shtesë, repektivisht hapja e brezeve është paraparë për fazën e dytë (Ref. Plani për hapjen e brezeve).</p>

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e IPKO Telecommunications LLC	Përgjigja e ARKEP
		<p>financiar, meqë planifikimi për vazhdim po bëhet 3 vite para skadimit.</p> <p>Në mënyrë që IPKO të jetë plotësisht i harmonizuar me Telekomin e Kosovës harmonizimit në raport me përdorimin e frekuencave, ju informojmë që IPKO është e interesuar që, në këtë proces të ripërtëritjes së autorizimeve, të aplikoj edhe për 5Mhz shtesë në brezin 1800Mhz. Konsiderojmë se kjo kërkesë e IPKO's duhet të plotësohet, sidomos duke pasur parasysh diferencën në pagesën për ndarjen e frekuencave ndërmjet IPKO dhe TK, qysh nga fillimi i licencimit.</p>	
		<p><b>Pagesa me këste</b> - Duke marrë parasysh gjendjen e tregut të telefonisë mobile ne tregun e Kosovës, është thelbësore që operatorët të mund të paguajnë me këste vjetore, për një periudhë prej 10 apo 15 vitesh, duke aplikuar metodën me interes fiks,</p>	<p>ARKEP konfirmon qëndrimin se operatorët kanë të drejtë të aplikojnë për periudha brenda intervalit: 10 deri 20 vite. Vlerësimi i brezeve frekuencore është bërë për periudhën 15 vjeqare, ndërsa për periudha të ndryshme përlllogaritja e cmimit do të bëhet sipas formulës:</p>

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e IPKO Telecommunications LLC	Përgjigja e ARKEP												
		<p>të propozuar në 2017, për alokimin e Brezin 2100MHz. Një mundësi e tillë duhet të bëhet me përqindje minimale të interesit, madje edhe më e ulët se tarifa e interesit e propozuar në vitin 2017, pasi kushtet e tregut janë edhe më të pavolitshme se në vitin 2017.</p> <p>Sa i përket kohëzgjatjes së autorizimit, IPKO, në parim, është e interesuar të aplikojë për rinovim për 15 vite, mirëpo, para se të vendos përfundimisht për këtë, na duhet vendimi final i ARKEP për çmimin si dhe për kushtet e pagesës (në rast se aplikohet mundësia e pagesës me këste), në mënyrë që IPKO pastaj të marr aprovimet dhe vendimin final lidhur me këtë.</p>	$Vlera e Brezitet_N = \left( \sum_{t=0}^{N-1} \frac{1}{(1+WACC)^t} / \sum_{t=0}^{15-1} \frac{1}{(1+WACC)^t} \right) \times Vlera e Brezitet_{15}$ <p>Sa i përket pagesës në këste, ARKEP në këtë proces lejon mundësinë e pagesës me këste vjetore të çmimit “one-off” sipas normës së interesit të Obligacioneve të Thesarit të Republikës së Kosovës, duke aplikuar normën e interesit në baza vjetore.</p> <p>Operatorët përveç mundësisë së pagesës së përnjëhershme “one off”, kanë mundësi të përzgjedhin një nga opsionet e ndarjes në këste si më poshtë, për të cilin do të paguajnë normë interesi respektiv të dhënë në këtë tabelë në kolonën mesatarja e baraspeshuar.</p> <table border="1" data-bbox="989 964 1934 1263"> <thead> <tr> <th data-bbox="989 964 1566 1073">Instrumenti (Obligacioni)/ ndarja në kiste</th> <th data-bbox="1566 964 1934 1073">Norma e interesit e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="989 1073 1566 1110">Ndarja në kiste 2 vjeçare</td> <td data-bbox="1566 1073 1934 1110">1.24507</td> </tr> <tr> <td data-bbox="989 1110 1566 1148">Ndarja në kiste 3 vjeçare</td> <td data-bbox="1566 1110 1934 1148">1.27999</td> </tr> <tr> <td data-bbox="989 1148 1566 1185">Ndarja në kiste 5 vjeçare</td> <td data-bbox="1566 1148 1934 1185">2.44155</td> </tr> <tr> <td data-bbox="989 1185 1566 1222">Ndarja në kiste 7 vjeçare</td> <td data-bbox="1566 1185 1934 1222">3.51486</td> </tr> <tr> <td data-bbox="989 1222 1566 1260">Ndarja në kiste 10 vjeçare</td> <td data-bbox="1566 1222 1934 1260">5.28238</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndërsa përlogaritja e pagesës vjetore llogaritet sipas formulës në vijim.</p>	Instrumenti (Obligacioni)/ ndarja në kiste	Norma e interesit e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar (%)	Ndarja në kiste 2 vjeçare	1.24507	Ndarja në kiste 3 vjeçare	1.27999	Ndarja në kiste 5 vjeçare	2.44155	Ndarja në kiste 7 vjeçare	3.51486	Ndarja në kiste 10 vjeçare	5.28238
Instrumenti (Obligacioni)/ ndarja në kiste	Norma e interesit e bazuar në Mesataren e Baraspeshuar (%)														
Ndarja në kiste 2 vjeçare	1.24507														
Ndarja në kiste 3 vjeçare	1.27999														
Ndarja në kiste 5 vjeçare	2.44155														
Ndarja në kiste 7 vjeçare	3.51486														
Ndarja në kiste 10 vjeçare	5.28238														

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e IPKO Telecommunications LLC	Përgjigja e ARKEP
			<p>Nëse autorizimi është për D vite dhe pagesa “one-off” do të bëhet sipas viteve për kohezgjatjen e autorizimit (D vite), atëherë pagesa vjetore për vitin e parë llogaritet:</p> $P1 = \frac{\text{Vlera e Brezitet}_D}{D}$ <p>Ndërsa pagesa ne keset tjera (D-1 këste të barabarta) llogaritet si ne vijim:</p> $\text{Pagesa Vjetore} = (\text{Vlera e Brezitet}_D - P1) \times \frac{i}{1 - (1 + i)^{1-D}}$ <p>Ku i- është norma e interesit/kuponit të Obligacioneve të Thesarit të Republikës së Kosovës e shprehur për D-1 vite</p> <p>Në rast të përcaktimit për pagesën me këste vjetore, me qëllim të sigurimit të realizimit të pagesës, ARKEP do të aplikoj mekanizmat adekuat të specifikuar në autorizime, duke përfshirë pasojat për operatorët për mos pagesë eventuale. Pagesa “one-off” ose kësti i parë, duhet të realizohet brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e lëshimit të fatures.</p> <p>Në rast se operatori nuk e përmbush obligimin për pagesë, atëherë ARKEP do të veproj si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për cdo vonesë në pagesa do të aplikohet masa ndëshkimore prej 8% për shumën e faturuar;</li> <li>- Në qoftë se për dy vite me radhë operatorët nuk kryejn pagesat e përcaktuara me Vendim, ARKEP nëpërmjet procedurës së përmbartimit do të ekzekutoj tërë shumën e mbetur duke përfshirë normën e aplikuar.</li> </ul>

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e IPKO Telecommunications LLC	Përgjigja e ARKEP
		<p>Përveç këtyre më lartë, ekipi ynë teknik ka hasur në disa gabime teknike, të cilat ne besojmë se duhet t'i keni në vëmendje gjatë përpilimit të dokumentit final:</p> <p>Faqe 7 specifikohet: a. Brezi 900 MHz (880- 915 &amp; 935- 960 MHz) me kapacitet në dispozicion prej 2x 35 MHz brezin 900 MHz mbesin në dispozicion edhe 2x13,6 MHz</p> <p>Koment:  IPKO = 2x10 MHz  Vala= 2x10 MHz  Totali i përdorur : 2x20 MHz  Totali ne dispozicion = 2x(35-20)= 2x 15 MHz -&gt; ku mbeten 1,4 MHz të tjera</p> <p>Faqe 7 specifikohet:  b. Brezi 1800 MHz ( 1710 – 1785 &amp; 1805 - 1880 MHz) me kapacitet në dispozicion prej 2x 75 MHz.  dhe 2 x 35 MHz në brezin 1800</p>	<p>Ne dokumentin “Plani per Hapjen e Brezeve”<sup>2</sup> eshte specifikuar se per brezin 900 MHz, kapaciteti prej 2x1.2 MHz eshte i alokuara per qellime militare, ndersa kapaciteti i planifikuar për dhënie në përdorim në procesin e hapjes së brezeve është 2x13.8 MHz.</p> <p>Sa i përket brezit 1800 MHz, kapaciteti i planifikuar për dhenie në perdorim ne procesin e hapjes së brezeve është 2x30 MHz, i cili është specifikuar edhe në dokumentin “Plani për Hapjen e Brezeve”.</p>

<sup>2</sup> [http://arkep-rks.org/repository/docs/Plani%20per%20hapjen%20e%20brezeve%20-%20Final%20dt%2008052019%20publikim%20\(1\).pdf](http://arkep-rks.org/repository/docs/Plani%20per%20hapjen%20e%20brezeve%20-%20Final%20dt%2008052019%20publikim%20(1).pdf)

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e IPKO Telecommunications LLC	Përgjigja e ARKEP
		MHz,  Koment: IPKO = 2x20 MHz Vala= 2x25 MHz Totali i përdorur : 2x45 MHz Totali ne dispozicion = 2x(75-45)= 2x 30 MHz -> jo 35 MHz	

Nr.	Pika ref. e dokumentit	Komentet e Dardafon.Net LLC	Përgjigja e ARKEP
		<p>Si shumë operatorë virtual në botë, që kur arrijnë shkallën e pjekurisë së tregut kanë sunim të zhvillohen në operatorë të rrjetit edhe ne besojmë që tashmë janë pjekur kushtet që një synim i tillë i yni të realizohet. Ne synojmë që të vazhdojmë të qëndrojmë në treg duke u rritur vazhdimisht dhe duke kërkuar mundësinë për të pasur në dispozicion brez frekuencor, dhe këtë e kemi shprehur edhe në letrën tonë drejtuar ARKEP me rastin e konsultimit publik për hapjen e brezeve me datë 1 Gusht 2018.</p> <p>Konsiderojmë se rilicencimi i operatorëve aktual është në të vërtetë hapje e brezeve frekuencore dhe prandaj kërkojmë që të na mundësohet edhe neve të marrim kapacitete frekuencore në brezet 900 dhe 1800 MHz. Prandaj, me këtë rast si kompani shprehim interesim që bazuar në nenet 48 dhe 49 të Ligjit për komunikimet elektronike të na ndahet në mënyrë të drejtëpërdrejtë brez frekuencor apo në ndonjë formë tjetër.</p> <p>Kompania jonë në asnjë formë nuk është për të penguar operatorët tjerë për rilicencim e aq më pak Telekomini e Kosovës, përkundrazi jemi të gatshëm të shqyrtojmë afatin kohorë të mundësisë së pajisjes sonë me brez frekuencor, por kjo nuk nënkupton privim nga e drejta jonë për pjesëmarrje në tregun e telekomunikimeve në Kosovë. Prandaj ne si kompani presim që kjo kërkesë legjitime të shqyrtohet nga ana e ARKEP.</p>	<p>Sa i përket kërkeses për alokimin e kapaciteteve në brezet 900 dhe 1800 MHz, ARKEP konsideron se ky është proces i ndarë nga ripërtirja e autorizimeve dhe caktimi i kapaciteteve për operatorin e ri (MNO), respektivisht hapja e brezeve është parapare për fazën e dytë (Ref. Plani për hapjen e brezeve).</p>